



**QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS
TATIMORE DHE DOGANORE**

RAPORT VJETOR

I VEPRIMTARISË

JANAR- DHJETOR 2023

Tabela e Përmbajtjes

QËLLIMI	4
OBJEKTIVAT	4
VEPRIMTARITË NË PËRPUTHJE ME KUADRIN E RI LIGJOR	4
PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE	6
VEPRIMTARITË NË FUSHËN E EDUKIMIT FISKAL	8
1. TRAJNIMET	8
2. PROGRAMET E TRAJNIMIT	8
3. PJESËMARRËSIT NË TRAJNIME	8
4. NUMRI I ORËVE TË TRAJNIMIT	9
5. VLERËSIMI I CILËSISË SË TRAJNIMEVE NGA PJESËMARRËSIT DHE TESTIMET	9
6. METODAT PROFESIONALE TË EDUKIMIT	10
ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA	12
PROGRAMET E TRAJNIMIT PËR VITIN 2023	12
AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE	14
<i>Trajnime të punonjësve niveli bazë</i>	14
Foto nga trajnimet me punonjësit e rinj të administratës tatimore	26
Testimi për punonjësit e rinj	27
<i>Trajnime të punonjësve niveli bazë – me kod pune</i>	28
Foto nga trajnimet me punonjësit me Kod Pune të administratës tatimore	36
Testimi për punonjësit e rinj	37
<i>Trajnime të punonjësve niveli vazhdues</i>	38
Foto nga trajnimet niveli vazhdues, administrata tatimore	46
<i>Trajnime të punonjësve niveli funksional</i>	47
Foto nga trajnimet me punonjësit funksionalë të administratës tatimore	53
<i>Trajnim për ligjin e ri të tatimit mbi të ardhurat</i>	54
AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE	55
<i>Trajnime të punonjësve të rinj</i>	55
Foto nga trajnimet me punonjësit e rinj të administratës doganore	64

Testimi për punonjësit e rinj	65
<i>Trajnime të punonjësve vazhdues</i>	66
Foto nga trajnimet me punonjësit vazhdues të administratës doganore	71
<i>Trajnime të nivelit funksional</i>	72
Foto nga trajnimet me punonjësit funksional të administratës doganore.....	79
Tabela e të dhënave për trajnimet me administratën tatimore.	80
Tabela e të dhënave për trajnimet e administratës doganore	85
Tabela përmbledhëse për trajnimet me administratën tatimore dhe doganore	89
Statistikat e rezultateve të testimit me punonjësit e rinj	90
Statistikat e formularëve të vlerësimit të trajnimit dhe trajnerëve nga ana e pjesëmarrësve	92
Realizimet nga sektori i Financës	93

QËLLIMI

Pasqyrimi i veprimtarisë së institucionit, zhvilluar në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të punonjësve të organeve fiskale dhe të orientimit të të trajnuarve në kuptimin e përgjegjësive të tyre teknike, profesionale në zbatim të legjislacionit fiskal.

OBJEKTIVAT

Krijimi i njohurive të reja dhe zgjerimi i njohurive ekzistuese rreth sistemit fiskal dhe ligjor nëpërmjet trajnimeve, duke krijuar mundësinë e shkëmbimit të njohurive mes kategorive të ndryshme të punonjësve të Administratës Tatimore dhe Doganore, aftësimin e tyre praktik dhe teorik.

Organizimi i procesit të edukimit në fushën fiskale duke pasur në fokus arritjen e objektivave strategjike të përgjithshëm të qeverisë.

Organizimi i trajnimeve në mënyrë efektive dhe efçente duke mbajtur një kosto sa më të ulët, por duke bërë të mundur zhvillimin cilësor të mësimdhënies.

Orientimi i trajnerëve dhe organizimi i workshopeve drejt çështjeve praktike duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit.

Zbatimi i planit të trajnimit bazuar në specifikimet e reja që rrjedhin nga aktet ligjore të miratuara për QTATD-në.

VEPRIMTARITË NË PËRPUTHJE ME KUADRIN E RI LIGJOR

Në 1 janar 2023 hyri në fuqi VKM-ja e re Nr. 602 “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore*”, datë 14.09.2022 dhe QTATD funksionoi në bazë të specifikimeve ligjore që përcaktohen aty.

Në zbatim të kësaj VKM-je kërkohet strukturë e re organizative që të përfshinte dhe trajnerë të brendshëm, në rolin e trajnerit për tema të caktuara dhe do të mbikqyresit të procesit të mësimdhënies.

Për këtë u hartua draft-struktura, relacionet shpjeguese dhe kalkulimet finaciare dhe u dërgua për miratim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e pasi kaloi të gjitha fazat e diskutimit dhe miratimit u dërgua në DAP, por për shkak të numrit të përgjithshëm të administratës shtetërore dhe të ndryshimeve në VKM-në e pagave dhe të emërtesave nuk u mor në shqyrtim gjatë vitit 2023, duke u shtyrë për vitin 2024.

Në vijimësi u hartuan draft rregulloret e brendshme dhe të trajnimit bazuar në propozimet për strukturën e re, të cilat do të miratohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë pas aprovimit të strukturës nga DAP.

U hartuan tre lloje të programeve të trajnimit të kërkuara nga VKM e re:

- të rinjtë-niveli bazë,
- niveli funksional,
- niveli vazhdues.

Për punonjësit e rinj u zgjeruan programet në afat-mesëm. Për nivelin funksional, pjesëmarrësit nga tatimet dhe nga doganat, thellojnë njohuritë e tyre teorike dhe praktike për një fushë të caktuar, të lidhur me detyrat e tyre funksionale. Për punonjësit vazhdues u hartuan programe specifike, duke përfshirë atë të ndryshimeve ligjore të ligjit të tatimit mbi të ardhurat.

Trajnimi i të gjithë funksioneve të administratës tatimore lidhur me ndryshimet që solli ligji i ri i tatimit mbi të ardhurat u zhvillua i ndarë në 10 seanca, ku u trajnuan rreth 1000 punonjës të administratës tatimore.

QTATD përgatiti 2 studime në fushën fiskale, të dyja publikuar në faqen zyrtare të web:

- “Rëndësia e Krijimit të një Strategjie E-Learning për Institucionet Trajnuese”,
- “Krahasim i Veprave Penale dhe Dënimeve Respektive në Fushën Tatimore në Shqipëri dhe disa Shtete të BE”.

Studimi i lidhur me E-Learning përqëndrohet në rëndësinë e sistemeve teknologjike në aktivitetet trajnuese. Ky studim ka si qëllim të shpalosë disa pika konkrete që një entitet mund të zhvillojë E-learning dhe ku duhet të fokusohet.

Studimi krahasues ka të dhëna e fakte për Shqipërinë dhe shtetet si Austria, Franca, Gjermania, Greqia, Holanda, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar lidhur me veprat penale në fushën tatimore dhe dënimet specifike lidhur me to.

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE

Në zbatim të VKM, nr.602, datë 14.09.2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”, që hyri në fuqi në Janar 2023, u hartuan programet dhe u planifikua organizimi i trajnimeve për 3 kategori programesh.

1. VEPRIMTARI TRAJNUESE

TRAJNIME		
•	Trajnimit bazë	<p>Organizuar për punonjësit dhe nëpunësit e rinj të administratës tatimore dhe doganore me qëllim që të pajisen me njohuri të rëndësishme themelore përkatëse të çdo fushe.</p> <p>Sipas këtij programi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga administrata tatimore u trajnuan 50 punonjës në 16 tema-150 orë trajnimi. • Nga administrata doganore u trajnuan 28 punonjës në 15 tema-114 orë trajnimi.
•	Trajnimit Vazhdues	<p>Organizuar për të gjithë punonjësit dhe nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore, me qëllimin që të krijohen njohuri të reja për çështje të veçanta dhe përditësimin e atyre ekzistuese, sipas dinamikave të fushës dhe të shkëmbehen përvojat dhe të transferohen njohuritë dhe dialogu ndërmjet stafit, lidhur me përditësimin me legjislacionin dhe praktikën e reja të zbatueshme.</p> <p>Sipas këtij programi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga administrata tatimore u trajnuan 1258 punonjës në 14 tema-228 orë trajnimi • Nga administrata doganore u trajnuan 314 punonjës në 8 tema-240 orë trajnimi.

<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimin Funksional 	<p>Organizuar për punonjësit dhe nëpunësit e administrates tatimore dhe doganore, për specializim në vendin e punës ose për zhvillimin e karrierës, ku njohuritë themelore dhe të përgjithshme thellohen përmes trajnimit që lidhet me funksionet përkatëse administrative.</p> <p>Sipas këtij programi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga administrata tatimore u trajnuan 239 punonjës në 11 tema-102 orë trajnimi. • Nga administrata doganore u trajnuan 261 punonjës në 13 tema-84 orë trajnimi.
--	--

2. VEPRIMTARI LIGJORE

VEPRIMTARITË SIPAS KUADRIT TË RI LIGJOR	
•	VKM-ja e Qendrës Nr. 602, datë 14.09.2022, hyri në fuqi më 1 Janar 2023.
•	U draftuan programet e reja të trajnimit mbi bazën e specifikimeve të reja ligjore.
•	U draftuan detyrat dhe rregullat sipas kuadrit të ri ligjor, rregullore e brendshme dhe ajo e trajnimit, të cilat janë gati për miratim nga MFE pas miratimit të strukturës së re organizative nga DAP.
•	U hartua struktura e re organizative me funksionet shtesë të trajnerëve të brendshëm dhe është dërguar në mënyrë të përsëritur në Ministri për miratim, kaloi fazat e miratimit atje dhe po rishqyrtohet pas vendimit të ri të Këshillit të Ministrave për kategoritë e pagave.

3. STUDIME

STUDIMET E KRYERA	
1	Rëndësia e Krijimit të një Strategjie E-Learning për Institucionet Trajnuese
2	Krahasim i Veprave Penale dhe Dënimeve Respektive në Fushën Tatimore në Shqipëri dhe disa Shtete të BE

VEPRIMTARITË NË FUSHËN E EDUKIMIT FISKAL

1. TRAJNIMET

Programet e Trajnimit përfshinin çështje bazë dhe specifike që lidhen me detyrat e ushtruara dhe ndryshimet ligjore të fushës fiskale. Pjesë të programit ishin tema trajnimi që përfshijnë dhe thellimin e njohurive të pjesëmarrësve në kuadër të trajnimeve me nivelin funksional si Lejimi i Përkohshëm apo zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e tatimeve.

Përzgjedhja e temave të trajnimit u mbështet kryesisht në kërkesat e administratave fiskale, në bazë të identifikimit që ato i bëjnë nevojave për trajnim në tema dhe njerëz, si dhe në sygjerimet e pjesëmarrësve dhe të trajnerëve dhe u paraqitën për diskutim dhe për miratim në Këshillin Konsultativ të Qendrës.

2. PROGRAMET E TRAJNIMIT

<ul style="list-style-type: none">• Miratuar për administratën tatimore: 40 tema trajnimi për 3 kategori pjesëmarrësish (të rinj, vazhdues dhe funksional).
<ul style="list-style-type: none">• Miratuar për administratën doganore: 36 tema trajnimi për 3 kategori pjesëmarrësish (të rinj, vazhdues dhe funksional).
<ul style="list-style-type: none">• Miratuar për të dy administratat tatimore dhe doganore: 76 tema në total.

3. PJESËMARRËSIT NË TRAJNIME

<ul style="list-style-type: none">• Pjesëmarrës në trajnime nga administratat tatimore- 1547 punonjës.
<ul style="list-style-type: none">• Pjesëmarrës në trajnime nga administratat doganore- 603 punonjës.
<ul style="list-style-type: none">• Pjesëmarrës në total të administratës tatimore dhe doganore 2150 punonjës.

4. NUMRI I ORËVE TË TRAJNIMIT

<ul style="list-style-type: none">• Orë të trajnimit për administratën tatimore për vitin 2023: 540 orë nga 540 orë të planifikuara për vitin 2023.
<ul style="list-style-type: none">• Orë të trajnimit për administratën doganore për vitin 2023: 438 orë nga 438 orë të planifikuara për vitin 2023.
<ul style="list-style-type: none">• 978 orë për të dy administratat.

5. VLERËSIMI I CILËSISË SË TRAJNIMEVE NGA PJESËMARRËSIT DHE TESTIMET

<ul style="list-style-type: none">• Numri total i pjesëmarrësve që morën pjesë në vlerësim: 1860.
<ul style="list-style-type: none">• Trajnimet u vlerësuan nga :<ul style="list-style-type: none">➤ 1829 ose 98.3% e pjesëmarrësve: shumë mirë➤ 30 ose 1.6% e pjesëmarrësve: mirë➤ 1 ose 0.1 % e pjesëmarrësve: mjaftueshëm➤ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: dobët
<ul style="list-style-type: none">• Trajnerët u vlerësuan nga :<ul style="list-style-type: none">➤ 1830 ose 98.3% e pjesëmarrësve: shumë mirë➤ 28 ose 1.6% e pjesëmarrësve: mirë➤ 2 ose 0.1% e pjesëmarrësve: mjaftueshëm➤ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: dobët

***Për administratën doganore** u testuan 28 punonjës të rinj në periudhë prove, nga të cilët 43% u vlerësuan shumë mirë, 39% u vlerësuan mire, por 14% u vlerësuan dobët.

***Për administratën tatimore** u testuan 27 punonjës të rinj në periudhë prove, nga të cilët 49% u vlerësuan shumë mirë, 11% u vlerësuan mirë.

Për administratën tatimore u testuan 12 punonjës të rinj të punësuar me Kod Pune, nga të cilët mbi 90% u vlerësuan shumë mirë dhe pjesa tjetër shkëlqyer.

VLERËSIMI	
DOGANA- TË RINJ	NR.
DOBËT (1-50)	4
MIRË (51-60)	11
SHUMË MIRË (61-80)	12
SHKELQYER(81-100)	1
TOTAL	28 Punonjës

VLERËSIMI	
TATIME- TË RINJ	NR.
DOBËT (1-50)	0
MIRË (51-60)	3
SHUMË MIRË (61-80)	13
SHKELQYER (81-100)	11
TOTAL	27 Punonjës

TATIME- KOD PUNE	
VLERËSIMI	NR.
DOBËT (1-50)	0
MIRË (51-60)	0
SHUMË MIRË (61-80)	11
SHKELQYER(81-100)	1
TOTAL	12 Punonjës

6. METODAT PROFESIONALE TË EDUKIMIT

Diskutime të rasteve praktike - me qëllim që punonjësit të vihen në rolin e vendim marrësit që përballen me një problem. Çdo seminar është shoqëruar me një hapësirë dedikuar rasteve praktike për ta bërë akoma më të prekshëm çdo problematikë sidomos duke pasur parasysh faktin që Qendra bën trajnimin e punonjësve të rinj të cilët nuk kanë eksperiencë.

Trajnerë nga radhët e metodistëve ose stafit drejtues të organeve fiskale- me qëllim përmirësimin e kompetencave të pjesëmarrësve në një fushë specifike, nëpërmjet demonstrimit të procesit të observimit, reflektimit dhe veprimit.

Diskutime të çështjeve praktike të hasura nga vetë pjesëmarrësit- me qëllim përmirësimin e praktikës profesionale, nëpërmjet angazhimit në ndarjen e çështjeve që shqetësojnë me njëri tjetrin si dhe mësimin me kolegët me të cilët kanë të njëjtin objektiv për të arritur.

Leksione studimore - me qëllim që të zgjidhen dilema lidhur me mënyrën e leximit dhe interpretimit të neneve të veçanta të ligjeve fiskale.

Konsultime – për të promovuar ndërgjegjësimin e inspektoreve dhe zhvillimin e tyre profesional nëpërmjet ofrimit dhe rekomandimit të mundësive të strukturuar për reflektim dhe observim.

Mbikqyrje reflektive - për të mbështetur, zhvilluar dhe vlerësuar punën e trajnerëve dhe performancën e pjesëmarrësve nëpërmjet një procesi pyetësorësh që inkurajon të kuptuarin dhe artikulumin e të arsyeshmes gjatë mësimdhënies dhe mësimarrjes.

Asistencë teknike - për të ndihmuar individët e organeve fiskale të përmirësohen, nëpërmjet ofrimit të informacioneve dhe burimeve të legjislacionit primar e sekondar, udhëzuesëve e manualeve sipas punës që mbulon secili dhe detyrave në përputhje me punën.

Testime – për të verifikuar shkallën e njohurive që zotërojnë, njohurive që marrin dhe për të vlerësuar nevojat e mëtejshme për trajnim specifik.

Qendra hartoi kalendarët e trajnimeve si mjet për organizimin e zhvillimit dhe duhur të trajnimit të kërkuar profesional të punonjësve të administratës tatimore dhe doganore. Qendra i planifikoi veprimtaritë e saj bazuar në filozofinë e zhvillimit ose përmirësimin profesional gjatë të punuarit të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me efektivitetin në punë si dhe të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me detyrat e përditshme të vendit të punës. Inspektorëve të tatimeve dhe punonjësve të doganave ju dha mundësia e zhvillimit profesional pa pagesë gjatë trajnimeve të përgatitura nga një nivel i lartë profesional trajnerësh dhe që varion gjerësisht në lidhje me filozofinë, përmbajtjen dhe formatin e eksperiencave të të mësuarit.

ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA

Orientimi i trajnerëve dhe organizimi i workshopeve është i fokusuar drejt seminarëve praktikë, duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit.

Trajnimet u zhvilluan në sallë, duke krijuar mundësinë e ndërveprimit aktiv mes pjesëmarrësve dhe trajnerëve.

Trajnimet u zhvilluan në degë të ndryshme tatimore dhe doganore, duke mundësuar jo vetëm organizimin e trajnimit, por dërgimin e trajnimit tek pjesëmarrësi. Trajnerët duke qenë se mbulojnë në jetët e tyre profesionale, si pjesë e organeve fiskale çështjet teknike që diskutohen, përveç koncepteve teorike janë orientuar drejt shpjegimit të rasteve konkrete nga praktika e punës, duke ia bërë më të prekshme temën e trajnimit pjesëmarrësve dhe duke pasur mundësinë që të ofrojnë zgjidhje ose unifikim interpretimesh.

PROGRAMET E TRAJNIMIT PËR VITIN 2023

U hartuan dhe miratuan në fillim të vitit programet e trajnimit si më poshtë:

ADMINISTRATA TATIMORE: 3 PROGRAME TRAJNIMI

- Programi i Trajnimit për punonjësit e rinj, 16 Tema, 25 ditë, 150 orë trajnimi.
- Programi i Trajnimit për nivelin funksional, 11 Tema, 21 ditë, 126 orë trajnimi.
- Programi i Trajnimit për nivelin vazhdues, 13 Tema, 21 ditë, 126 orë trajnimi për çdo rajon.

ADMINISTRATA DOGANORE: 3 PROGRAME TRAJNIMI

- Programi i Trajnimit për punonjësit e rinj, 15 Tema, 19 ditë, 114 orë trajnimi.
- Programi i Trajnimit për nivelin funksional, 13 Tema, 14 ditë, 84 orë trajnimi.
- Programi i Trajnimit për nivelin vazhdues, 8 Tema, 8 ditë, 48 orë trajnimi, për çdo rajon.

TRAJNIM MBI LIGJIN 90/2023, DATË 30.03.2023 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”.

- U trajnuan punonjësit e administratës tatimore me: 10 ditë trajnimit, 60 orë total.

Me administratat tatimore dhe doganore është zhvilluar trajnimi me programet për punonjësit e rinj, si edhe programet për punonjësit vazhdues dhe funksionalë.

Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve:

- U koordinua midis institucioneve në lidhje me pjesëmarrësit në këto trajnime.
- U përzgjedhën dhe u koordinua me trajnerët në lidhje me metodologjinë që përdoret në trajnimet në sallë si dhe në lidhje me materialet e prezantimit dhe dokumentat shoqërues për secilin trajnim.
- U hartuan e dërguan kalendarët e trajnimit.
- U zhvilluan seminarët.
- U dërguan materialet e trajnimeve për pjesëmarrësit, si edhe u ndoqën e përpunuan formularët e vlerësimit për trajnimin.

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE

Trajnime të punonjësve niveli bazë

AKTIVITETI I

"Tatimi mbi Vlerën e Shtuar."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 31 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Karakteristikat e TVSH-së;
- Fusha e zbatimit;
- Pragu i regjistrimit;
- Kufiri;
- Furnizimi i mallrave;
- Furnizimi i mallrave kundrejt pagesës;
- Vetëfurnizimi;
- Dhënia në përdorim e aktiveve të shoqërisë;
- Transaksionet e ndërmjetme;
- Furnizimi i shërbimeve;
- Lindja dhe kërkimi i tatimit;
- Kërkueshmëria;
- Shkalla tatimore;
- Të ardhurat dhe niveli i taksës;
- Shembuj.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me ligjin për TVSH-në për të përmirësuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Pjesëmarrësit kanë zgjeruar njohuritë lidhur me kuadrin ligjor, si dhe karakteristikat e TVSH-së, fusha e zbatimit, pragu i regjistrimit, kufiri, furnizimi etj.

AKTIVITETI II

"Njohuri bazë në Legjislacionin Tatimor"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 19 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale .

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Legjislacioni tatimor;
- Llojet e tatimeve dhe taksave;
- Përkufizime;
- Detyrimi tatimor;
- Të drejtat dhe detyrimet e agentit;
- TP rezident dhe jorezident;
- Caktimi PT të personave jo rezident;
- Kontrolli tatimor;
- Njoftimi i kontrollit tatimor.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore me qëllim dhënien e njohurive bazë të legjislacionit tatimor, kontrollit Tatimor, shërbimit të tatimpaguesve, rregjistrimit të tatimpaguesve, ndryshimet në rregjistrim, menaxhimi i çështjeve në sistem etj.

AKTIVITETI III

"Të ardhurat Personale"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 27 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Rezidenca;

- Tatimi mbi të ardhurat personale;
- Të ardhura të tatueshme;
- Përjashtimet nga tatimi mbi të ardhurat personale;
- Shkalla tatimore;
- Deklarimi individual vjetor i të ardhurave;
- Afatet e dorëzimit të deklaratës individuale;
- Shpenzime të zbritshme;
- Mbajtja e regjistrimeve;
- Dokumentet të cilat vërtetojnë të ardhurat;
- Dokumentat që justifikojnë shpenzimet e zbritshme;
- Tatimi mbi fitimin;
- Subjekte të tatim fitimit;
- Fitimi i tatueshëm;
- Shpenzime të njohura.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me ligjin për “Tatimin mbi të Ardhurat” për të përmirësuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Pjesëmarrësit kanë zgjeruar njohuritë e tyre lidhur me kuadrin ligjor, si dhe thelluar njohuritë mbi të ardhurat që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale, shkallën tatimore, deklarin individual vjetor të të ardhurave etj.

AKTIVITETI IV

“Tatimi në Burim”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 27 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Rezidenca;
- Tatimi në burim;
- Pagesat mbi të cilat mbahet tatimi në burim;
- Dividentët;
- Ndarja e fitimit;
- Interesat;
- Pagesat për të drejtat e autorit.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me ligjin për „Tatimin mbi të Ardhurat“ për të përmirësuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Pjesëmarrësit kanë zgjeruar njohuritë e tyre lidhur me kuadrin ligjor për “Tatimin në Burim” dhe kanë diskutuar raste konkrete nga praktika.

AKTIVITETI V

“Tatimi mbi Fitimin”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 27 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Ligji për tatimin mbi fitimin;
- Subjekte të tatim fitimit
- Tatimpaguesit rezidente dhe jo rezidente;
- Subjektet e përjashtuara nga Tatim fitimi;
- Fitimi i tatueshëm;
- Shpenzime të panjohura;
- Parapagimet;
- Deklarimi tatimor;
- Fitimi pas tatimit.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me ligjin për “Tatimin mbi të Ardhurat” për të përmirësuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Pjesëmarrësit kanë zgjeruar njohuritë e tyre lidhur me kuadrin ligjor për “Tatim Fitimin” dhe kanë diskutuar raste konkrete nga praktika.

AKTIVITETI VI

“Organizimi Tregtar Auditimi”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 19 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Format e ndryshme të organizimit tregtar;
- Procedurat e likuidimit dhe falimentimit;
- Administratori;
- Shoqëria aksionare;
- Këshilli i administrimit. Sistemi me një nivel;
- Administratorët dhe këshilli mbikëqyrës, sistemi me dy nivele;
- Vlerësimi tatimor dhe auditimi;
- Regjistrimi i personave juridike, që ushtrojnë veprimtari tregtare;
- Përditësimi i të dhënave të regjistrimit;
- Kalimi në regjistrin pasiv;
- Likuidimi/Falimentimi/Çregjistrimi;
- Bashkimi/Ndarja;
- Kontrolli.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me procedurat e likuidimit dhe falimentimit, administratori, shoqëria aksionare, këshilli i administrimit, sistemi me një nivel, administratorët dhe këshilli mbikëqyrës, sistemi me dy nivele.

AKTIVITETI VII

“Hetimi Tatimor”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 21 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Struktura dhe funksionet e hetimit tatimor;
- Baza ligjore;
- Manuali i hetimit tatimor;
- Evazioni tatimor;
- Veprat penale në lidhje me tatimet;
- Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar;
- Fshehja e të ardhurave;
- Sektori i administrimit të informacionit dhe analizës;
- Sektori i parandalimit të pastrimit të parave.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me dhënien e njohurive rreth mbledhjes së informacionit tatimor, hetimin tatimor, ndjekjen dhe zbatimin e masave shtrënguese, marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.

AKTIVITETI VIII

“Avokati i Tatimpaguesit”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 21 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Funksionet e Avokatit;
- Klasifikimi i rasteve të paraqitura;

- Hetimi i çështjeve në shqyrtim;
- Identifikimi i rasteve për trajtim nga administrata tatimore.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me organizimin, misionin, fushën e përgjegjësisë, kompetencat e avokatit të tatimpaguesve.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit "Mbi Krijimin e Qendrës së Përbashkët Trajnuese" mes Shqipërisë dhe Kosovës, për këtë trajnim morën pjesë edhe punonjës të administratës tatimore të Kosovës.

AKTIVITETI IX

“Transferimi i Çmimit”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 19 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Njohja me rregullimin ligjor i transferimit të çmimit;
- Parimet bazë;
- Metodat e transferimit të çmimit;
- Vlerësimi i transaksioneve të kontrolluara të kombinuara;
- Diapazoni i treguesve të tregut;
- Rregullimet korresponduese;
- Marrëveshjet e çmimit në avancë;
- Dhënia e informacionit mbi transferimin e çmimit.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me rregullimin ligjor të transferimit të çmimit dhe parimet bazë, metodat e transferimit të çmimit, vlerësimi i transaksioneve të kontrolluara të kombinuara, diapazoni i treguesve të tregut, rregullimet korresponduese, marrëveshjet e çmimit në avancë, dhënia e informacionit mbi transferimin e çmimit.

AKTIVITETI X

“Kontabiliteti”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 21 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Parimet bazë të kontabilitetit;
- Ndarja e kontabilitetit;
- Raportet e kontabilitetit;
- Koncepte e nocione të përgjithshme mbi të ardhurat;
- Të ardhurat e ushtrimit në sektorin publik, përmbajtja, klasifikimi dhe struktura;
- Trajtimi i evidencës kontabël të të ardhurave.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me konceptet dhe nocionet e përgjithshme mbi të ardhurat, të ardhurat e ushtrimit në sektorin publik, përmbajtja, klasifikimi dhe struktura, trajtimi i evidencës kontabël të të ardhurave, sistemi i informacionit kontabël ne biznes, etj.

AKTIVITETI XI

“Apelimi Tatimor dhe Gjykata Administrative”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 19 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Akti administrativ;
- E drejta e ankimit administrativ;

- Ankimi administrativ ndaj akteve të administratës tatimore;
- Struktura e apelimit tatimor;
- Përfaqësimi i tatimpaguesit;
- Aktet administrative, objekt ankimi pranë DAT;
- Kërkesat formale të ankimit administrative;
- Raste trajtimore etj.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me procedurat administrative, nocioni i aktit administrativ, struktura e apelimit tatimor, kushtet paraprake që duhet të plotësohen për apelimin tatimor, interesi legjitim i palës, afati i ankimit në drejtorinë e apelimit tatimor etj.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit "Mbi Krijimin e Qendrës së Përbashkët Trajnuese" mes Shqipërisë dhe Kosovës, për këtë trajnim patëm pjesëmarrës punonjës të administratës tatimore të Kosovës.

AKTIVITETI XII

“Dokumentimi Tatimor dhe Fiskalizimi”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 24 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Çfarë është fiskalizimi?
- Ku mund të marr informacion?
- Kuadri ligjor për fiskalizimin;
- Çfarë është një faturë, përmbajtja dhe kërkesat për lëshimin e faturës;
- Procedura e fiskalizimit dhe e lëshimit të faturave tatimore;
- Portali Selfcare për të lëshuar fatura;
- Regjistrimet për pagesat me dhe pa para në dorë;
- Dispozita të veçanta në lidhje me fiskalizimin;
- Shembuj praktikë;
- Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit;
- Pyetje-përgjigje.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me fiskalizimin dhe përmirësimin e modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit "Mbi Krijimin e Qendrës së Përbashkët Trajnuese" mes Shqipërisë dhe Kosovës, për këtë trajnim patëm pjesëmarrës punonjës të administratës tatimore të Kosovës.

AKTIVITETI XIII

“Taksat Kombëtare dhe Vendore”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 18 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Procedurat e zbatimit të ligjit dhe e ndryshimeve në ligj;
- Taksat vendore dhe mënyra e administrimit të tyre;
- Kuptimi i taksës dhe i tarifës;
- Raste konkrete.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me ligjin “Për taksat kombëtare” kuptimi i taksës dhe tarifës, taksat dhe administrimi i tyre etj.

AKTIVITETI XIV

“Procedura e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 19 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSH TJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Afatet;
- Vlerësimin e riskut;
- Masat e sigurimit të detyrimit tatimor;
- Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
- Sekuestrimi i xhiros;
- Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
- Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
- Ankimimi i masës së sigurimit të detyrimit tatimor;
- Sekuestrimi, konfiskimi;
- Shitja ne ankand, transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë etj.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me procedurat e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara dhe përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit.

AKTIVITETI XV

“Marrëveshjet Tatimore”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 20 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale.

ÇËSH TJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Baza ligjore për hartimin e marrëveshjeve tatimore;
- Marrëveshjet tatimore për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin;
- Bazat e interpretimit të marrëveshjeve tatimore;
- Struktura tip e marrëveshjeve tatimore;
- Fusha e veprimit të marrëveshjeve tatimore;
- Të ardhurat biznesore etj.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me marrëveshjet tatimore dhe/ose konventat tatimore për “Eliminimin e Taksimit të Dyfishtë dhe Tatimor mbi të Ardhurat dhe Kapitalin”.

AKTIVITETI XVI

“Kontrolli Tatimor”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 23 pjesëmarrës, respektivisht specialistë dhe Inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit, Menaxhimit të Riskut, Drejtorisë për Proceset e Biznesit, Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Financës etj, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale .

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Arsyet e ushtrimit të kontrollit tatimor;
- Ushtrimi i kontrolleve të arsyeshme;
- Aftësia që duhet të ketë kontrollori;
- Plani mujor i kontrollit;
- Zgjedhja e tatimpaguesve, që do të kontrollohen;
- Disa nga elementet e riskut për zgjedhjen e TP për kontroll;
- Përdorimi i burimeve të informacionit;
- Verifikimet e kryer nga kontrolli;
- Fitimi mbi kapitalin e përdorur;
- Përqindja e fitimit bruto;
- Dënimet administrative nenet 111-132.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me procedurat e “Kontrollit Tatimor”.

Foto nga trajnimet me punonjësit e rinj të administratës tatimore



Testimi për punonjësit e rinj

Në përfundim të programit të trajnimit për punonjësit e rinj të administratës tatimore, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore organizoi testimin mbi vlerësimin e njohurive të fituara nga pjesëmarrësit, ku morën pjesë 27 pjesëmarrës.

EVIDENCA

VLERËSIMI	NR. PUNONJËSISH
DOBËT (1-50)	0
MIRE(51-60)	3
SHUME MIRË (61-80)	13
SHKELQYER (81-100)	11
TOTAL	27 Punonjës

48% e pjesëmarrësve u vlerësuan me rezultat shumë të mirë, duke marrë 60 –80 % të pikëve, si edhe 41% u vlerësuan me shkëlqyer, rezultat që tregon absorbimin e njohurive të reja të marra në mënyrë të kënaqshme.

Pjesëmarrësit ishin aktiv, treguan interes për leksionet e marra, si edhe angazhim në mënyrën si aktivizoheshin.

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE

Trajnime të punonjësve niveli bazë – me kod pune

AKTIVITETI I

"Njohuri bazë në Legjislacionin Tatimor"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove me Kod Pune, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 9 pjesëmarrës, respektivisht Inspektorë nga Drejtoria e Hetimit tatimor në Drejtorinë e përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoria e Verifikimit në Terren nga Rajonet.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Legjislacioni tatimor;
- Llojet e tatimeve dhe taksave;
- Përkufizime;
- Detyrimi tatimor;
- Të drejtat dhe detyrimet e agjentit;
- TP rezident dhe jorezident;
- Caktimi PT të personave jo rezident;
- Kontrolli tatimor;
- Njoftimi i kontrollit tatimor.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me legjislacionin tatimor, kontrollin tatimor, shërbimit të tatimpaguesve, regjistrimit të tatimpaguesve, ndryshimet në regjistrim, menaxhimi i çështjeve në sistem etj.

AKTIVITETI II

"Tatimi mbi Vlerën e Shtuar"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove me Kod Pune, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 11 pjesëmarrës, respektivisht Inspektorë nga Drejtoria e Hetimit tatimor në Drejtorinë e përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoria e Verifikimit në Terren nga Rajonet.

ÇËSH TJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Karakteristikat e TVSH-së;
- Fusha e zbatimit;
- Pragu i regjistrimit;
- Kufiri;
- Furnizimi i mallrave;
- Furnizimi i mallrave kundrejt pagesës;
- Vetëfurnizimi;
- Dhënia në përdorim e aktiveve të shoqërisë;
- Transaksionet e ndërmjetme;
- Furnizimi i shërbimeve;
- Lindja dhe kërkimi i tatimit;
- Kërkueshmëria;
- Shkalla tatimore;
- Të ardhurat dhe niveli i taksës;
- Shembuj etj.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me ligjin për TVSH-në për të përmirësuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre. Pjesëmarrësit kanë zgjeruar njohuritë e tyre lidhur me kuadrin ligjor, si dhe karakteristikat e TVSH-së si: fusha e zbatimit, pragu i regjistrimit, kufiri, furnizimi etj.

AKTIVITETI III

“Dokumentimi Tatimor dhe Fiskalizimi”

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Tatimore. Në trajnim morën pjesë 9 pjesëmarrës, respektivisht Inspektorë nga Drejtoria e Hetimit tatimor në Drejtorinë e përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoria e Verifikimit në Terren nga Rajonet.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Çfarë është Fiskalizimi?
- Ku mund të marr informacion?
- Kuadri ligjor për Fiskalizimin;
- Çfarë është një faturë, përmbajtja dhe kërkesat për lëshimin e faturës;
- Procedura e fiskalizimit dhe e lëshimit të faturave tatimore;
- Portali Selfcare për të lëshuar fatura;
- Regjistrimet për pagesat me dhe pa para në dorë;
- Dispozita të veçanta në lidhje me fiskalizimin;
- Shembuj praktikë;
- Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit;
- Pyetje-përgjigje.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore lidhur me fiskalizimin dhe përmirësimin e modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit.

AKTIVITETI IV

“Të ardhurat Personale”

